



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 256/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërjez. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi–Referues, z. Goran Milenković –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Laguna” Sh.p.k.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “Mobile Sanitary Services” Sh.p.k–Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së” me nr. prokurimit: 11600-19-1260-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Administrata Tatimore e Kosovës /ATK/, më datën 25.06.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Laguna” Sh.p.k.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së” me nr. prokurimit: 11600-19-1260-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Administrata Tatimore e Kosovës /ATK/.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së” me nr. prokurimit: 11600-19-1260-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Administrata Tatimore e Kosovës /ATK/.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Laguna" Sh.p.k.-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 18.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike, kornizë, shërbim

Vlera e parashikuar e kontratës: 115,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës (N.52) tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 08.04.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 08.04.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm është bërë me dt: 17.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 20.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 22.05.2019.

Operatori ekonomik ankues "Laguna" Sh.p.k.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2019, me nr. 256/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së" me nr. prokurimit: 11600-19-1260-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Administrata Tatimore e Kosovës /ATK/, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.



Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 05.06.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt:17.06.2019, sqaron pretendimin e OE ankues, ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pagën prej 270.94 bruto apo 250.00 neto, OE i cili është shpallur fitues është me një çmim vjetor prej 100,078.08 euro prej 8,339.84 euro. Ky operator është (minus) -631.44 euro vjetor ose 52.62 euro mujore nën çmimin real me paga dhe TVSH.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK dhe dokumentacionit në lende në vijim ju paraqet në detaje si kalkulohet paga e punëtorit në rastin konkret orar i plotë 40 orë në javë.

Çmimi për Orë të rregullta	Totali i Orëve të rregullta uara	Paga Bruto Për orët e rregullta 6 x 7	TOTALI Paga Bruto 8 + 15 Euro (€)	Kontributet				Paga që tatohet 16 – 19 Euro (€)	TATI MI Euro (€)	PAGA NETO 21 – 22 Euro (€)	Paga Netë 23 – 24 Euro (€)
				Punëtori %	Punëdhësi %	Punëtori 16 x 17 Euro (€)	Punëdhësi 16 x 18 Euro (€)				
6	7	8	16	17	18	19	20	21	22	23	25
6.77	40.0	270.94	270.94	5.0 %	5.0 %	13.55	13.55	257.39	7.39	250.00	250.00

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e AK-së tek specifikimet e detyrueshme teknike kërkesë ka qenë: Paga bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) nga Ofruesi i shërbimeve kërkohej të jetë së paku 270.94 € për një muaj, ndërsa paga neto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) të jetë së paku 250.00 € për një muaj. Nga operatori ekonomik kërkohej që të dorëzojë një deklaratë origjinale të vulosur dhe të nënshkruar se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) dhe pagën neto për një punëtor/e (pastrues/e).

Deklarata nga OE për pagesat e pagave ndaj 25 punëtor/e kërkohej të dorëzohet para propozimit të AK për dhënie të kontratës dhe ti dorëzohet AK-së brenda 5 ditëve pas marrjes së kërkesës nga AK; nëse OE nuk dorëzon deklaratën e kërkuar oferta e OE do të refuzohet si i papërgjegjshme.

Po ashtu nga OE i propozuar për dhënie të kontratës do të kërkohej të dorëzojë një deklaratë origjinale të nënshkruar dhe vulosur ku do të vërtetojë se në periudhë prej së paku tre muajve ka kapacitet financiar me mjete likuide afatshkurta për ti kryer pagesat e pagave të pastruesve.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentet në lende konstaton se OE Mss Mobile Sanitary Services Sh.P.K ka të bashkangjitur këto deklaratë që sipas nenit

Eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur ne ofertë një deklaratë se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e), pagën neto për një punëtor/e (pastrues/e). Dhe një deklaratë që vërteton se në periudhë prej së paku tre muajve ka kapacitet financiar me mjete për ti kryer pagesat e pagave të pastruesve.

#### Sqarim 1:

Paga për një punëtor  $270.94 \times 25 \text{ punëtor} = 6.773,5$  pagat për 25 punëtoret për një muaj

$6.773,5 \times 12 \text{ muaj} = 81.282$  pagat e punëtoreve për një vite

$81.282 \times 18\% = 14.630,76$  TVSH për një vite

$81.282 \text{ pagat e punëtoreve për një vite} + 14.630,76 \text{ TVSH për një vit} = 95.912,76$  totali i pagave me TVSH për një vite.

Kontributi që duhet të paguaj punëdhënësi (detyrim) është  $13.55 \times 25 \text{ punëtor} = 338.75$  për një muaj ose 4.065 që duhet të paguaj për 25 punëtoret për një vite. Nga kjo del se totali i pagave me TVSH +kontributi i paguar nga punëdhënësi  $95.912,27 + 4.065$  arrijnë vlerën prej 99.977,27 që i bie që OE i rekomanduar për kontratë i mbulon pagat e punëtorëve siç është kërkuar ne dosjen e tenderit me çmimin e ofruar ne oferte prej 100.078,08€ .

#### Sqarim 2:

Kontributi i punëtorëve që është obligim të paguhet nga punëdhënësi nuk hynë të paga bruto kjo pages ne rastin konkret është në vlerë prej 13.55 euro ne muaj apo 4.065 ne vit,

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së tek njoftimi për kontratë, dosjen e tenderit dhe dokumentet e dozuara në ofertën konstaton se paga dhe kontributi pensional i paguar nga punëdhënësi duhet të zbatohet gjatë implementimit te kontratës por jo gjatë vlerësimit te ofertave.

Meqenëse OE MSS "Mobile Sanitary Services SH.P.K i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e AK tek specifikimet e detyrueshme teknike duke i bashkangjitur në oferte deklaratat e kërkuara ne lidhje me pagat e punëtoreve.

Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK Administrata Tatimore e Kosovës.



Autoriteti Kontraktues ATK, përmes parashtresës me shkrim të datës: 17.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "Laguna" Sh.p.k.-Prishtinë, me datë: 19.06.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 25.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Ademideklaroj: Edhe një here vlerësojmë për këtë AP OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka respektuar pagën punëtorëve prej 270.94 euro bruto ashtu siç është kërkuar në DT tek spec. teknike. Vlerësojmë se OE i rekomanduar për kontrate në bazë të analizës financiare është minus 631.44 euro vjetor ose 52.62 euro nën çmimin mujor duke mos llogaritur edhe materialin higjienik. Sa i përket ekspertizës edhe në ekspertizë edhe në analizën të financiar vetëm pagat e punëtorëve me kontribute arrijnë vlerën 85.347 euro vjetor, ndërsa OE në procesverbalin e hapjes së ofertave ka një çmim prej 84.811.93 euro që do të thotë nuk e ka respektuar pagën duke mos venë në shprehje TVSH-në. Sa i përket vendimit të kërkesë për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues është lëshuar në disa detaje duke bërë verifikim të kompanisë se sa paguajmë TVSH e që konsiderojmë është shkelje e nenit 84 të LPP-së duke zbuluar të dhënat se a paguajmë TVSH e që nuk ethe dashur të vijë në shprehje ngaqë kriteret kanë qenë të qarta edhe TVSH-në të kalkuluar 18 % e jo sa paguan një kompani. Faturimi i cili bëhet pas kryerjes së shërbimeve është 18% dhe si i tillë duhet të faturohet. Tek specifikimet teknike është sasia e materialit mujor e që veç në rubrikën 1 për një muaj janë kërkuar 61 komplete paloma për duar dhe tualete e që minimumi i një kompleti është 17 euro ndërkohë që MSS i rekomanduar për kontrate është me çmim prej 8 euro mujore konsiderojmë që nuk është bërë ekzaminimi vlerësimi siç duhet. Në edhe vitin e kaluar kemi pas kontratës me ATK-në e që lënda ka ecur edhe përmes OSHP-së me pretendime të njëjta ankimore e që OSHP për atë AP ka lëshuar urdhëresë 418/17 andaj nuk besoj që OSHP do të marrë vendime kundërtë. Nëse.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-së z. Duraku deklaroj: Se pari panelit i dorëzoj provat materiale që të kenë parasysh gjatë vendimmarrjes. Pajtohem me raportin e E.SH. 256/19 të datës



06.06.2019 i cili propozon qe ankesa e OE te hudhet poshtë si e pabazuar dhe rekomandon qe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues për dhenje te kontratës. Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit te OE ne këtë seance për konfialidit te dhënat i kam marr nga zyrtaret e ATK-se dhe unë kam bere një moster krahasuese profesionale duke cekur vetëmne përqindje jo ne vlera duke marr parasysh normane TVSH 18% dhe përqindja me efekt te derdhur ne arkën e shtetit ka dal 3.36% ne vitin 2018 pra shume larg pretendimeve siç pretendohet se paguhet 18% dhe ne rastin konkret TVSH e llogaritur me 18% është 1280.20 ne muaj ndërsa ne vit i bien 15.362.49 ndërsa për afërsisht ne arkën e shtetit derdhen 2388.98 euro ne muaj ose 2887.70, ne vit qe diferenca i bien 12.494.73 cent qe pretendohet ne emër te 18% ndërsa kjo shume nuk derdhet ne arkën e shtetit. Pastaj parimi kryesor është qe TVSH nuk llogaritet ne paga, paga është kategori e shpenzimeve, LPP dhe Rregulla e përcakton qarte se duhet ofertën financiare te kërkuar ne DT qe ne rastin konkret ka qen hapësira e shprehur për m2 Panelit i ofrova 8 prova materiale përfshi ofertën financiare te OE MSS dhe Laguna qe ekanë plotësuar siç është kërkuar ne DT deklaraten betim te OE MSS deklaraten e OE MSS se do te plotësoj pagën 270.94 cent bruto dhe 250 euro neto, deklaraten se do te respektoj te gjitha obligimet qe dalin nga ligji i punës, dhe mbi bazën e kësaj poqese një kritë i vetëmnuk do te plotësohet do te ndërpritet kontrata do ti konfiskohet sigurimi dhe do te dorëzohet lënda ne OSHP për ta futur ne listën e zeze për dokumente te rrejshme te ofruara. Nëse te njëjtat nuk i plotëson. Kjo rregullohet me rregullat me rregullat për tenderin anormal me te ulet nëse ofertat financiare kanë dallim te madh Autoriteti Kontraktues mund ta shpall si oferte te pazbatueshme mirëpo ne rastin ne fjale dallimi ne mes OE Laguna dhe OE MSS është vetëm 4% qe do te thotë është shume e përafërt.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja profesionale e prokurimit znj. Bekadekloroj: E kam dhen përgjigjen ne raportin e datës 17.06.2019 ku pretendimi i OE ankues ka qen se nuk i plotëson pagën. Mbes prapa raportit te dorëzuar ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Ademidekloroj: Kërkojmë qe ankesa jone te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Duraku deklaroj: Kërkojmë te refuzohet ankesa e OE si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në



procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues “Laguna” Sh.p.k.-Prishtinë, pretendon se OE i rekomanduar për kontratë “Mobile Sanitary Services” Sh.p.k –Prishtinë, nuk e ka plotësuar pagën prej 270.94 bruto apo 250.00 neto. Ndërsa është shpallur fitues është me një çmim vjetor prej 100,078.08 euro prej 8,339.84 euro, OE në fjalë është (minus) -631.44 euro vjetor ose 52.62 euro mujore nën çmimin real me paga dhe TVSH.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në kërkesat e AK-së ATK, dhe dokumentacionit në lëndë ka paraqitur në detaje se si kalkulohet paga e punëtorit në rastin konkret orar i plotë 40 orë në javë.

Çmimi për Orë të rregullta	Totali Orëve të rregullta	Paga Bruto	TOTALI Paga Bruto 8 + 15	Kontributet				Paga që tatohet	TATI MI	PAGA NETO	Paga Net
				Punëtori	Punëdhësi	Punëtori	Punëdhësi				
		Për orët e rregullta		%	%	16 x 17 Euro	16 x 18 Euro	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)
6	7	8	16	17	18	19	20	21	22	23	25
6.77	40.0	270.94	270.94	5.0 %	5.0 %	13.55	13.55	257.39	7.39	250.00	250.00

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në kërkesën e AK-së tek specifikimet e detyrueshme teknike kërkesë ka qenë si vijim :

Paga bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 270.94 € për një muaj, ndërsa paga neto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) të jetë së paku 250.00 € për një muaj. Nga operatori ekonomik kërkohet që të dorëzojë një deklaratë origjinale të vulosur dhe të nënshkruar se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e) dhe pagën neto për një punëtor/e (pastrues/e).

Deklarata nga OE për pagesat e pagave ndaj 25 punëtor/e kërkohet të dorëzohet para propozimit të AK për dhënie të kontratës dhe të dorëzohet AK-së brenda 5 ditëve pas marrjes së kërkesës nga AK; nëse OE nuk dorëzon deklaratën e kërkuar oferta e OE do të refuzohet si e papërgjegjshme.

Po ashtu nga OE i propozuar për dhënie të kontratës do të kërkohet të dorëzojë një deklaratë origjinale të nënshkruar dhe vulosur ku do të vërtetojë se në periudhë prej së paku tre muajve ka kapacitet financiar me mjete likuide afatshkurta për të kryer pagesat e pagave të pastruesve.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se OE i rekomanduar për kontratë Mss Mobile Sanitary Services Sh.P.K ka të bashkangjitur këto deklaratë. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur në ofertë e tij një deklaratë se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor/e (pastrues/e), pagën neto për një punëtor/e (pastrues/e). Dhe një deklaratë që vërteton se në periudhë prej së paku tre muajve ka kapacitet financiar me mjete për të kryer pagesat e pagave të pastruesve.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se:

Sqarim 1:

Paga për një punëtor  $270.94 \times 25 \text{ punëtor} = 6.773,5$  pagat për 25 punëtoret për një muaj  
 $6.773,5 \times 12 \text{ muaj} = 81.282$  pagat e punëtoreve për një vit.

$81.282 \times 18\% = 14.630,76$  TVSH për një vit.

$81.282$  pagat e punëtoreve për një vit +  $14.630,76$  TVSH për një vit  $= 95.912,76$  totali i pagave me TVSH për një vit.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se kontributi që duhet të paguaj punëdhënësi (detyrim) është  $13.55 \times 25 \text{ punëtor} = 338.75$  për një muaj ose  $4.065$  që duhet të paguaj për 25 punëtoret për një vit. Nga kjo del se totali i pagave me TVSH + kontributi i paguar nga punëdhënësi  $95.912,76 + 4.065$  arrijnë vlerën prej  $99.977,27$  që i bie që OE i rekomanduar për kontratë "Mobile Sanitary Services" Sh.p.k – Prishtinë, i mbulon pagat e punëtorëve siç është kërkuar në dosjen e tenderit me çmimin e ofruar në ofertë prej  $100.078,08\text{€}$ .

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se:

Sqarim 2:

Kontributi i punëtorëve që është obligim të paguhet nga punëdhënësi nuk hynë të paga bruto kjo pagë në rastin konkret është në vlerë prej  $13.55$  euro në muaj apo  $4.065$  në vit.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në kërkesat e AK-së ATK, tek njoftimi për kontratë, dosjen e tenderit dhe dokumentet e dozuara në ofertën konstaton se paga dhe kontributi pensional i paguar nga punëdhënësi duhet të zbatohet gjatë implementimit të kontratës por jo gjatë vlerësimit të ofertave.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se OE MSS "Mobile Sanitary Services SH.P.K i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e AK tek specifikimet e detyrueshme



teknike duke i bashkangjitur në oferte deklaratat e kërkuara në lidhje me pagat e punëtorëve. Andaj duke u nisur nga sqarimet me lart paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se pretendimet ankimor të OE ankues janë të pa bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet në detajet të ekspertës profesionale të prokurimit vlerëson se autoriteti kontraktues ka respektuar procedurat në harmoni me nenet 59 dhe 60 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dëlëndëne prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK –Administrata Tatimore e Kosovës.

1x1 OE –“Laguna” Sh.p.k.-Prishtinë,

1x1 Arkivit të OSHP-se

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

